



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:124658

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05477489

KF. nr. 279/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “M.” B.I., me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.E. nga Ferizaji, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti Vlerësim Tatimor, vlerë kontesti 65,733,87 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit H.E., dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditurës, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “M.” B.I., me seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET aktvendimi nr. 94/2021 i datës 12.05.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE, tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur, me datë 17.06.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.94/2021 të datës 12.05.2021, të Divizionit të Ankesave dhe lënda të vendoset në dobi të biznesit “M.”. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se me kërkesë të inspektorit të ATK-ës është kërkuar stoku i biznesit këtu paditësit dhe ky stok u është dhënë inspektorit për kontroll, në kuadër të atij stoku

ka pasur mallra te materialit ndërtimor si dhe makineri prodhuese. Esenca qëndron aty se inspektori ka kontestuar stokun e makinerisë, ngase kur ai e ka bere kërkesën ka kërkuar librat e blerjes dhe shitjes si dhe stokun, nuk ka specifikuar se ma referoni vetëm stokun e materialit ndërtimor por ka kërkuar stok te përgjithshëm. Beje precizimin kërkesë padisë ashtu qe kërkojë nga gjykata te aprovohet padia si e bazuar, te anulohet vendimi kontestues 94/2021 i datës 12.05.2021 dhe lënda te rikthehet tek paditura, ashtu qe njëjta te konstatoje gjendjen e sakte te stokut mbi bazën e dokumentacionit kontabël dhe gjendjes faktike te cilën posedon biznesi. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 02.03.2023, ka theksuar se e konteston padinë në tërësi si të pabazuar dhe konsideron se vendimi i DA/ATK-së, si palë e paditur në këtë konflikt administrativ është i bazuar në ligj, duke propozuar që të refuzohet kërkesëpadija e paditësit si e pa bazuar, dhe të vërtetohet vendimi i DA të ATK-së nr. 94/2021 i datës 12.05.2021, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka pranuar ftesën, nuk ka prezantuar duke e njoftuar Gjykatën me parashtrësën e datës 08.03.2024, se nuk do prezantoj në seancë dhe njëherit ka kërkuar nga Gjykata të veprohet komfor nenit 38, par 5 të LKA-së, andaj Gjykata komfor nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtrësat e të paditurës. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi nr. 94/2021 i datës 12.05.2021 të Administratës Tatimore të Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 12.03.2024 ka administruar provat dhe atë: certifikata e regjistrimit te biznesit ne ARBK e datës 14.09.2012, së bashku me informatat mbi biznesin, raport kontrolli nr.67 i datës 08.02.2021, tabela, stoqet të datës 31.12.2019, 31.12.2014, 30.09.2020, 31.12.2018, 31.12.2017, 31.12.2016, 31.12.2015, DUD-i 23973/02.09.2015, fatura nr. 024457, pro fatura nr.04-2015, formularët e deklaramit te TVSH-ës dhe tatimit ne te ardhura personale, vendimi 94/2021 i datës 12.05.2021, forma për vizite përmbushëse e datës 05.05.2021, 27.10.2020, 16.12.2020, 21.12.2020, 02.02.2021, 08.02.2021, 09.02.2021, përgjigja ne padi e datës 02.03.2023, listë distribuimi i ATK-ës e datës 06.05.2021, ankesa e ushtruar ne ATK e datës 12.03.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga Raporti i Kontrollit dt. 08.02.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të raportit të kontrollit dt. 09.02.2021, ka ushtruar ankesë me datë 05.03.2021, pranë Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e për të cilën ankesë, ATK-ë me datë 12.05.2021 ka sjell Aktvendimin nr. 94/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit akt, paditësi me padinë e datës, 17.06.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj Gjykate.

Gjykata nga vendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim. Në vendimin e kontestuar është dhënë arsyetimi se duke u bazuar në nenin 15 të Ligjit 03L-222-Mbledhja e Informatave dhe Provave, verifikimin e sjell nga Regjioni ku është konstatuar se në selinë e biznesit nuk ka stoqe, andaj pretendimet e tatimpaguesit nuk i ka mundur të i merr si argument i mjaftueshëm dhe esencial për të ndryshuar Njoftim Vlerësimet e tatimit shtesë të caktuar me kontroll, mirëpo për Gjykatën një arsyetim i tillë është i mangët dhe i pa qartë dhe si i tillë është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit, sepse e paditura nga vlerësimi i inspektorit tatimor në trajtimin e stokut si mungesë nuk e ka analizuar strukturën e stokut por tërë stokun e ka trajtuar si mall ndërtimor dhe nuk ka vërtetuar se mjetet e punës-mjetet themelore a i posedon në pronësi tatimpaguesi apo i ka shitur, dhe pse nuk sqaruar se a ekziston kontrata për dhënie të aseteve me qira e paditësit me biznesit “Brigo” Sh.P.K, siç e paditura ka pasur obligim të bëjë sipas nenit 37 par. 3 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se vendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse në

dispozitiv të të njëjtit nuk është vendosur lidhur me pjesën respektivisht pikat e refuzuara, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj doemos edhe është dashur të anulohet.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative, dispozitivi i vendimit i mangët dhe kontradiktor me arsyetimin, si dhe me provat e theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në vendimin e kontestuar dhe në raportin e kontrollit të datës 08.02.2021, për subjektin këtu paditësin “M.” Sh.P.K, me seli në Ferizaj, Gjykata konstaton se nuk vërtetohet parregullsia në mbajtjen e librave dhe regjistrimeve apo shkeljeve ligjore për deklarimin dhe pagimin e tatimeve nga ana e paditësit. E paditura tek përshkrimi i fakteve në rastin e kontrollit, por edhe në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se gjatë kontrollit në gjendjen e përgjithshme ka figuruar stok i mbetur, pra me dokumentet në fund të periudhës 2016, në vlerë prej 289,493.43 €, e që fizikisht nuk e ka poseduar atë. E paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm ti mjaftonte ky konstatim abstrakt nga i cili nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, kur paditësi është ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë sikurse në raportin e kontrollit të datës 08.02.2021.

Nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata konsideron se e paditura gjatë kryerjes së kontrollit tatimor për paditësin ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-222, nenin 19.2, dhe nenin 27 të UA nr.15/2010 për zbatimin e këtij ligji, paragrafi 7 nën par. 7.7 pika 7.7.5, si dhe paragrafin 12 të nenit 27 të UA nr.15/2010, ku parashihet përmbajtja e raportit të kontrollit, për arsye se vlerësimi tatimor me kontroll në këtë rast, nuk është kryer sipas gjykimit më të mirë dhe provat në dispozicion që ka ATK, siç parashihet me ligj.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të rregulloj dispozitivin e vendimit ashtu që i njëjti të përfshijë saktë përse është refuzuar ankesa, si dhe të deklarohet se

mbi bazën e cilave prova konkrete e ka ngarkuar paditësin me detyrime tatimore për periudhën e kontrollit. Në ri procedurë e paditura të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, të verifikoj dhe të konstatoj saktë stokun e makinerisë duke marrë për bazë edhe kontratën e qirasë për shfrytëzim të metëve të punës, të realizoj vizitë përmbushëse tek këtu paditësi dhe tek subjekti tjetër “Brigo” Sh.P.K, dhe vetëm pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Tutje ligji 05/L-031, në nenin 47, ka të përcaktuar Strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, e ku sipas këtij neni akti administrativ i shkruar përmban, në paragrafin 1.2. të tije edhe : *pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.* Tutje Neni 52, parag 1. i këtij ligji përcakton shprehimisht se *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: nën paragrafi 1.4 është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrative.* Nga Interpretimi i drejtë i këtyre dispozite dhe nga dispozitivi i vendimit kontestues del se i njëjti përveç që nuk është i zbatueshëm ngase nuk tregon se q ‘farë është vendosur, i njëjti është edhe i paligjshëm sipas nenit 52, parag 1, nën parag 1.4 të Ligjit 05/L-031.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.279/22, datë 12.03.2024

Zyrtare Ligjore

Amire Jahiri

Gj y q t a r i

Fisnik Nuli

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.